



Studimet Universitare,

**PRITSHMËRITË
DHE
ZGJEDHJET E
TË RINJVE**

Qendresa Kukaj

Rrezart Dema

Eliona Qerimi

www.universum-ks.org

Autorë:

Qendresa Kukaj, MA.

Rrezart Dema, MA.

Eliona Qerimi, BSc

Botues:

Departamenti i Kërkimeve Shkencore

Instituti për Studime Ekonomike dhe Sociale

Kolegji Universum

Këshilli Editorial:

Arlinda Berisha

Uran Rraci

Ky hulumtim është përkrahur nga Zyra e Karrierës e Kolegjit Universum dhe është realizuar me kontributim e studentëve të Kolegjit Universum të gjeneratës 2018/2019 në kuadër të lëndës Metodave Hulumtuese.

Tabela e përmbajtjes

Tabela e figurave	3
Qëllimi i hulumtimit	4
1. Shqyrtim i literaturës	5
2. Metodologjia	8
2.1. Kufizimet metodologjike	9
2.2. Mostra e hulumtimit.....	10
3. Organizimi dhe struktura e shkollave të mesme në Kosovë	12
4. Gjetjet e studimit	14
4.1. Të dhëna demografike	14
4.2. Faktorët që ndikojnë përzgjedhjen e drejtimit të studimeve	19
4.3. Pritjet e maturantëve për profesionet dhe të ardhurat e ardhshme	23
5. Përfundime dhe rekomandime	25
6. Bibliografia	27

Tabela e figurave

Figura 1. Gjinia e të anketuarve	14
Figura 2. Vendbanimi i të anketuarve	14
Figura 3. Të ardhurat mujore të të anketuarve	15
Figura 4. Lloji i shkollave ku vijojnë mësimet të intervistuarit	15
Figura 5. Përcjellja e orientimit në karrierë gjatë shkollës së mesme.....	16
Figura 6. Vendimi për të vazhduar studimet	17
Figura 7. Vendi i preferuar për studime	17
Figura 8. A e kanë zgjedhur maturantët drejtimin e studimeve	18
Figura 9. A e kanë zgjedhur maturantët institucioni ku do t'i vazhdojnë studimet	18
Figura 10. Lloji i institucioneve të preferuara për studime.....	18
Figura 11. Institucionet e preferuara për studime	18
Figura 12. Ekzistimi i listave me opsione rezervë për institucionet e studimit	19
Figura 13. Faktorët që ndikojnë pranimin në studime sipas besimit të maturantëve	20
Figura 14. Faktorët që ndikojnë vendimin e maturantëve për studime.....	21
Figura 15. Faktorët që ndikojnë zgjedhjen e institucionit për studime.....	21
Figura 16. Burimet e informacionit më të përdorura nga maturantët.....	22
Figura 17. Burimet më të besuara nga maturantët	22
Figura 18. Burimet e financimit të studimeve.....	23
Figura 19. Planet e maturantëve pas diplomimit.....	24
Figura 20. Vendi i dëshiruar i punësimit të maturantëve.....	24
Figura 21. Faktorët që ndikojnë në gjetjen e punës.....	24

Qëllimi i hulumtimit

Në vitet e fundit në Kosovë shumë shpesh është ngritur çështja e mospërputhjes në mes të drejtimeve të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë dhe kualifikimeve të të rinjve në një anë dhe aftësive të kërkuara në tregun e punës, në anën tjetër. Këtë e tregon një raport i Bankës Botërore (Cojocar, 2017) sipas të cilit në Kosovë 43% e bizneseve të mëdha me më shumë se 100 punëtorë vlerësojnë se pengesa kryesore në mos përmbushjen e të gjitha vendeve të punës është arsimiti i papërshtatshëm i kandidatëve. Studime të tjera të shumta fokusohen në identifikimin e hendekut në mes të aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe kualifikimeve të të rinjve dhe nxjerrin rezultate të ngajshme. Megjithatë, pak flitet për arsyet pse të rinjtë zgjedhin të ndjekin drejtime të caktuara të studimeve dhe të përfitojnë kualifikime të caktuara. Pikërisht identifikimi i faktorëve që ndikojnë vendimet për ndjekjen e studimeve universitare tek të rinjtë Kosovarë është qëllimi i këtij studimi.

Përvec identifikimit të hendekut në mes të aftësive të kërkuara në tregun e punës dhe aftësive që posedojnë të rinjtë, është e rëndësishme të shqyrtohen të gjitha mundësitë që mund të përdoren për zvogëlim të këtij hendeku. Në këtë aspekt, analizimi i procesit të vendimmarrjes së të rinjve për ndjekje të studimeve universitare paraqet një faktor që ka hapësirë të shpjegojë një masë të madhe të hendekut dhe rezultatet mund të përdoren nga institucionet shtetërore përgjegjëse, shkollat e mesme dhe institucionet e arsimit të lartë për të dizajnuar programe dhe përpjekje që formësojnë perceptimet e të rinjve dhe i drejtojnë ata kah përfitimi i aftësive që janë më të kërkuara në treg.

1. Shqyrtim i literaturës

Studime të shumta mbulojnë çështjen e zgjedhjes së profesionit nga të rinjtë. Shumë prej tyre listojnë pritjet për fitimet e ardhshme, afërsinë nga shtëpia, koston e të tjera si faktorë kryesorë që përcaktojnë drejtimin dhe institucionin që zgjedh një individ për t'i vazhduar studimet.

Një studim i realizuar nga “Sussex Learning Network” dhe “Aimhigh Sussex”, është projektuar për të kuptuar zgjedhjet e bëra nga studentët me bazë në Sussex, të kuptojë më mirë proceset e vendimmarrjes së studentëve dhe të zbulojë variabla kyç të përfshirë në arsimin e studentëve dhe në zgjedhjet e ardhshme të punësimit. (Smith, 2012) Nxënësit në vitet e fundit të shkollës së mesme u intervistuan rreth zgjedhjeve që kanë të bëjnë me të ardhmen e tyre: nëse do të shkonin në arsimin e lartë ose drejt në punësim. Shumica e studentëve që morën pjesë në hulumtim e theksuan ambicien e tyre për prospektet e mira të punësimit dhe paga të konsiderueshme si rezultat i marrjes së një diplome në Arsimim të Lartë. Mundësia e punësimit në të ardhmen renditet e treta në kriteret për zgjedhjen e një institucioni akademik e për shumë studentë, të ardhurat e ardhshme dhe përparimi në karrierë ishin të lidhura ngushtë me këtë. Nxënësit pjesëmarrës në studim e konsideruan vazhdimin në arsim të lartë si një vendim me rrezik të lartë, për shkak të kostos së lartë të studimit dhe potencialit për pasoja negative afatgjata, nëse drejtimi i zgjedhur rezulton i gabuar për ta, ose nuk rezulton me punësim të menjëhershëm. Studimi gjeti dëshmi për të sugjeruar që studentët kërkojnë shumë informata të detajuara për një periudhë të zgjatur kohe para se të bëjnë zgjedhjet e tyre përfundimtare. Kostoja e jetesës, disponueshmëria e akomodimit dhe vendndodhja ishin tre kriteret kryesore për zgjedhje të një fakulteti/institucioni apo drejtimi. Kostoja e taksave për shkollim u rendit e katërta, duke sugjeruar që studentët brengosen për aspektet financiare të vazhdimin të studimit universitare.

Një studim tjetër i realizuar në këtë fushë është hulumtimi afatgjatë nga Ingels dhe Dalton i cili përfshin 23.000 nxënës të klasave të nënta. Studimi filloi në vitin 2009 kur këta nxënës u intervistuan për herë të parë dhe pastaj vazhdoi edhe me një raund të dytë të intervistimit në vitin 2012 kur nxënësit ishin në klasën e njëmbëdhjetë. Ky studim përfshinte pyetje rreth karakteristikave që do të ndikonin në zgjedhjen e shkollës ose kolegjit pas shkollës së mesme. Nxënësit kishin zgjedhur tre faktorët që ata i konsideronin si "shumë të rëndësishme" të cilat ishin

cilësia dhe reputacioni akademik që u ofrohet nga institucionet e ndryshme, që të ketë një program studimi të dëshiruar dhe mundësia për sigurim të një vendi pune. Dy të tretat e studentëve pjesëmarrës në studim vlerësonin koston e studimeve si një ndikim "shumë të rëndësishëm" në zgjedhjen e tyre të kolegjit. Ndërsa largësia nga shtëpia si dhe statusi i trashëgimisë familjare ishin përzgjedhur si "shumë të rëndësishme" nga një përqindje shumë më e vogël e nxënësve. Pavarësisht nga gjendja socio-ekonomike, mbi 95% e të anketuarve e kishin vlerësuar koston e vijshmërisë si një "faktor disi të rëndësishëm" ose "shumë të rëndësishëm" në zgjedhjen e tyre të kolegjit. (Ingels, S.J., and Dalton, B., 2013)

Në vitin 2011 u realizua një hulumtim në Turqi nga Uyar (Uyar et al., 2011) për të parë arsyet pse studentët e zgjedhin "Kontabilitetin" si degë të studimit dhe për të kuptuar nëse kjo degë studimi u me dëshirat, qëllimet dhe shkathtësitë e tyre apo jo. Pjesëmarrës në këtë studim ishin 320 studentë të universitetit "Fatih", prej të cilëve vetëm 179 e përfunduan pyetsorin. Në pyetjen "A e keni plan të punoni në fushën e kontabilitetit?" me përgjigjen "Po" u përgjigjen 69 nga 179 studentë, dhe nese "Po" ata u pyetën "pse dëshironi të studioni në këtë degë?" ku shumica deklaruan se aty ka më shumë hapsirë për të gjetur punë. Ky studim tregon se vendimet e tyre për studime bazohen më shumë në prospektet e tyre për punësim në kuadër të një fushe.

Një hulumtim i mëvonshëm që e ka bërë Yousef (Yousef et al, 2017), qëllimi i të cilit ishte të hulumtojë mbi depresionin dhe faktorët e tjerë që ndikojnë në studentët e infermierisë u realizua në kolegjin e infermierisë në universitetin "Jordan" të shkencës dhe teknologjisë. Arsyeja e këtij hulumtimi ishte për të parë se sa dhe si ishte e ndikuar zgjedhja e tyre për ta marrë këtë drejtim në kolegji. Gjatë këtij hulumtimi studentët i zgjedhën arsyet që kishin dhe tri prej tyre dominuan nga të tjerat. Zgjedhja e familjes, faktorët religjiozë dhe dëshira për tu kujdesur për të tjerët ishin shqetësimet që nxënësit kishin në mendje më së shumti. Student të cilët kanë zgjedhur infermierinë sepse kishin dëshirë të kujdeseshin për të tjerët, kishin nivel më të vogël të depresionit, po ashtu ata të cilët e zgjedhën këtë drejtim për arsye religjioze kishin nivel më të vogël të depresionit. Kurse në anën tjetër ata të cilët e kanë zgjedhur infermierinë për shkak se kanë qenë në presionin e familjes ose nuk kanë pasur alternativa tjera kanë qenë në depresion më të madh.

(Cullen et al, 2016) kreu një hulumtim për të parë përse studentët e rinjë dëshirojnë të studiojnë maminë dhe të regjistrohen në programin bachelor të mami në Australi. Ky hulumtim u krye në “Griffith University” dhe “Gold Coast University Hospital” në Australi. Hulumtimi gjeti se disa studentë e kishin zgjedhur këtë profesion nga dashuria e tyre për bebet e sapolindura. Gjatë këtij hulumtimi kishte edhe raste ku familiarët ose këshilltarët e karrierës i kishin këshilluar pjesëmarrësit që të shkonin në infermieri pastaj në mami. Por kishte raste të studentëve që edhe pse u këshilluan nga të afërmit ti vijonin studimet e tyre në infermieri, ata thjeshtë nuk e gjenin vetën në atë drejtim.

Pra, nga të gjitha këto hulumtime vërehet se, ndër faktorët tjerë, faktori më i rëndësishëm në të menduarit për regjistrimin në një kolegji ose program studimi është drejtpërdrejt i lidhur me karakterin e personit që do të studiojë dhe kushtet e mjedisit në të cilin ata lindin. Faktorë të tjerë që ndjekin këto janë disiplinat e kolegjeve apo programeve arsimore, ose dallimet midis gjinive, ndërsa distanca nga shtëpia dhe familja e personit që do të studiojë është gjithashtu e rëndësishme. Vendimet e marra në moshën rinore mund të ndryshojnë lehtë dhe mund të preken lehtësisht nga faktorët e mjedisit. Ndërsa disa të rinj vendosin se çfarë duan të studiojnë në moshën 12 vjeçare, disa prej tyre, madje edhe në të 20-at, nuk mund të qartësojnë vendimet e tyre. Personat që do të arsimtohen mund të marrin vendime në përputhje me dëshirat e tyre për arritje individuale, vendosmërinë e tyre për të arritur sukses, përvojën e tyre akademike etj. Gjithashtu faktorët psikologjikë kanë një rëndësi të madhe në zgjedhjen e një profesioni.

Një tjetër aspekt që duhet marrë parasysh me rastin e analizimit të vendimit për studime universitare është niveli i besimit që individët kanë në sistemin udhëheqës dhe në tregun e punës në një vend. Nëse individët besojnë se, pavarësisht njohurive dhe aftësive të tyre të fituara gjatë shkollimit formal dhe jo formal, shanset për punësim varen nga njohjet e tyre, lidhjet familjare dhe afërsia me partitë në pushtet, atëherë kjo mund të ndikojë që ata të mos zgjedhin programet e studimit që përshtaten me talentet dhe pasionet e tyre, por të orientohen drejt atyre ku ka më shumë siguri për punësim.

Sipas Kane dhe Rouse (1999), ndërsa ekonomia zhvillohet, kualifikimet dhe njohuritë do të bëhen më të rëndësishme, cilësia dhe përshtatshmëria e kualifikimeve të prodhuara nga sistemi i arsimit

dhe trajnimit do të jetë e nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe krijimin e vendeve të punës. Ne jetojmë në epokën e teknologjisë dhe studentët janë të vetëdijshëm për të gjitha këto zhvillime. Prandaj, kur zgjedhin një universitet, ata mendojnë më shumë se një herë dhe dëshirojnë të përqëndrohen në fusha që japin më shumë garanci për punësim.

Në Kosovë, tregu i punës kërkon më shumë vëmendje për shkak të nivelit më të lartë të papunësisë së të rinjve. Duke pasur parasysh se Kosova ka avantazhin e një fuqie punëtore të re për të konkurruar me vendet e tjera, investimi në rininë duhet të konsiderohet si një nga prioritetet e strategjisë së zhvillimit të vendit. Prandaj, është e rëndësishme të studiohen faktorët që ndikojnë vendimmarrjen e tyre për studime në mënyrë që të kuptohet më mirë procesi i zgjedhjes dhe kjo të mund të përdoret në shërbim të hartimit të politikave dhe programeve më të përshtatshme që mbështesin edukimin dhe punësimin e të rinjve.

2. Metodologjia

Dy pyetjet hulumtuese të këtij studimi janë:

1. Cili është procesi i zgjedhjes së drejtimit të studimeve dhe institucionit të arsimit të lartë nga të rinjtë kosovarë?
 - A. Identifikimi i të gjithë hapave në procesin e zgjedhjes së drejtimit të studimeve dhe institucionit të arsimit të lartë nga të rinjtë kosovarë
 - B. Identifikimi i faktorëve që ndikojnë zgjedhjen e drejtimit të studimeve dhe të institucionit të arsimit të lartë nga të rinjtë kosovarë
 - C. Identifikimi i periudhës kohore/kohëzgjatjes së procesit të përzgjedhjes së drejtimit të studimeve dhe institucionit të arsimit të lartë nga të rinjtë kosovarë
 - D. Identifikimi i burimeve të informacionit të konsultuara nga të rinjtë me rastin e zgjedhjes së drejtimit të studimeve dhe të institucionit të arsimit të lartë nga të rinjtë kosovarë

2. Cilat janë pritshmëritë e të rinjve kosovarë lidhur me studimet e larta në Kosovë?

Hulumtimi është zhvilluar në dy faza.

Faza e parë: Me qëllim të ofrimit të një pasqyre të qartë të mospërputhjeve në mes të aftësive të kërkuara në tregun e punës dhe të aftësive e kualifikimeve që posedojnë të rinjtë kosovarë, është realizuar një hulumtim themelor dhe shqyrtim literature dhe dokumentesh lidhur me llojin dhe numrin e shkollave të mesme dhe institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

Faza e dytë: Për qëllim të mbledhjes së të dhënave empirike lidhur me procesin e zgjedhjes dhe pritshmërive të të rinjve kosovarë për studime universitare, është realizuar një anketë me maturantët e shkollave të mesme nga rajoni i Prishtinës, Ferizajit dhe Gjakovës. Kjo anketë ka eksploruar procesin e përzgjedhjes, faktorët që ndikojnë përzgjedhjen, burimet e informacionit të përdorura gjatë përzgjedhjes, kohën kur të rinjtë fillojnë procesin e përzgjedhjes, kohën kur të rinjtë marrin vendimin dhe pritshmëritë e tyre për studime universitare. Rajonet e Prishtinës, Gjakovës, dhe Ferizajt janë përzgjedhur për arsye praktike të realizimit të anketës, meqë Kolegji Universum ka kampuse në këto tri qytete dhe ishte më e lehtë për studentët t'i realizojnë pyetësorët nëse fokusohen në këto rajone.

2.1. Kufizimet metodologjike

Dizajni i këtij hulumtimi paraqet tri kufizime metodologjike: 1. Në anketë nuk janë përfshirë individët që nuk janë maturantë dhe planifikojnë të regjistrohen në studime universitare gjatë vitit akademik 2019/2020; 2. Në hulumtim janë përfshirë vetëm regjioni i Prishtinës, Ferizajit dhe Gjakovës, për arsye praktike të realizimit të anketës. Me këtë rast, ka mundësi që dallime të mëdha në procesin e zgjedhjes që vijnë si pasojë e dallimeve kulturore, sociale apo ekonomike ndërmjet regjioneve të ndryshme të jenë lënë jashtë studimit. 3. Meqenëse realizimi i hulumtimit ka përfunduar disa muaj para se të rinjtë të marrin vendimin përfundimtar dhe të regjistrohen në një drejtim studimesh, do të thotë se ata ende nuk kanë përfunduar një cikël të procesit të zgjedhjes së studimeve. Prandaj, vetëm nga përgjigjet e tyre është më e vështirë njohja dhe analizimi i komplet procesit të zgjedhjes.

2.2. Mostra e hulumtimit

Në Kosovë çdo vit mesatarisht përfundojnë arsimin e mesëm të lartë 27.000 maturantë. Por, pasi që ky studim është fokusuar vetëm në regjionet e Prishtinës, Ferizajit dhe Gjakovës, popullacionin e këtij hulumtimi e përbëjnë maturantët e këtyre regjioneve.

Kështu, gjatë vitit shkollor 2018/2019 në Kosovë janë të regjistruar gjithsej 13,915 maturantë. Për këtë popullacion është e nevojshme të merret një mostër prej 573 personash, me marzhë gabimi prej 4%.

Procedura e mostrimit që është përcjellur është mostrimi i shtresuar. Nga tërë popullacioni, 19% janë nga Gjakova, 25% nga Ferizaj dhe 56% nga Prishtina. Rrjedhimisht, mostra ka qenë proporcionale dhe është ndarë ndërmjet këtyre rajoneve si vijon:

- Gjakova: 19%, 109 anketa
- Prishtina: 56%, 322 anketa
- Ferizaj: 25%, 144 anketa

Rajoni i Gjakovës përfshin komunat e Gjakovës, Deçanit, Junikut dhe Rahovecit. Në këtë rajon janë gjithsej 16 shkolla të mesme të larta.

Rajoni i Ferizajit përfshin komunat e Ferizajit, Shtimes, Kacanikut, Shterpcës dhe Hanit të Elezit. Në këtë rajon janë gjithsej 14 shkolla të mesme të larta.

Rajoni i Prishtinës përfshin komunat e Prishtinës, Obiliqit, Fushë Kosovës, Lipjanit, Artanës, Besianës dhe Drenasit. Në këtë rajon janë gjithsej 21 shkolla të mesme të larta.

Komuna	Shkolla të mesme	Maturantë	% e nr te nxenesve	Respondentë	Respondentë për shkollë
Prishtinë	14	3,499	45%	146	10
Fushë Kosovë	3	522	7%	22	7
Podujevë	4	1,433	19%	60	15
Obiliq	2	242	3%	10	5
Lipjan	5	1,072	14%	45	9
Novoberdë	1	4	0%	0	0
Gracaninë	0
Drenas	2	947	12%	40	20
Totali Prishtinë:	31	7,719		322	
Gjakovë	9	1,374	51%	56	6
Junik	1	63	2%	3	3
Decan	2	424	16%	17	9
Rahovec	4	767	29%	31	8
Totali Gjakovë:	16	2,682		107	
Ferizaj	8	2,313	66%	95	12
Shtime	2	537	15%	22	11
Kacanik	2	495	14%	20	10
Shterpcë	1	57	2%	2	2
Hani i Elezit	1	112	3%	5	5
Totali Ferizaj	14	3,514		144	

Tabela 1. Pjesëmarrësit në mostren e hulumtimit

3. Organizimi dhe struktura e shkollave të mesme në Kosovë

Arsimi i mesëm i lartë në Kosovë paraqet nivelin tre (3) sipas SNKA-së (Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit) dhe funksionon në shkolla të mesme publike dhe jopublike (të licencuara). Në bazë të synimeve dhe përmbajtjes këto shkolla janë të organizuara në gjimnaze dhe në shkolla profesionale. Shkollat e mesme të larta (gjimnazet dhe shkollat profesionale) janë shkolla të profilizuara. Gjimnazet ndahen sipas drejtimeve në: shoqërore, të përgjithshme, të shkencave natyrore, matematikë-informatikë dhe të gjuhëve. Ndërsa shkollat e mesme profesionale ndahen sipas drejtimeve në: teknike, bujqësore, ekonomike, të mjekësisë, të muzikës, të tregtisë, teologjike, të artit dhe në qendra të kompetencës.

Në tërë Kosovën në vitin 2019 ishin 119 shkolla të mesme me gjithsej 24.191 maturantë. Kushtet dhe zhvillimet aktuale në tregun e punës në vend kryesisht imponojnë që të rinjtë të kenë aftësi si njohja e gjuhëve të huaja, dhënia e shpejtë e informatës, aftësi analitike, aftësitë menaxheriale, aftësitë për menaxhim të projekteve, aftësi profesionale/teknike, mendimi kritik, aftësi financiare, aftësi komunikimi, aftësi për zhvillim të aplikacioneve softuerike, mendimi logjik, aftësi për zgjidhjen e problemeve, aftësi të shkrimit akademik, aftësi për të punuar në ekip, aftësi hulumtimi, aftësi për përdorimin e teknologjisë informative, për shkrimin e raporteve, aftësi për menaxhimin e rrjeteve sociale dhe aftësi të shitjes.

Sa i përket aftësimin profesional, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, menaxhon tetë Qendra të Aftësimin Profesional (QAP) të cilat janë të koncentruara në shtatë Rajonet e Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan, Mitorvicë dhe Doljane (pjesa veriore e Mitrovicës) me 69 punëtorë dhe 30 profesione të ndryshme. Në këto qendra bëhet aftësimi dhe ri-aftësimi i personave që janë të regjistruar si punëkërkues, të papunë dhe ata që marrin shërbimet për orientim në karrierë, pranë të gjitha zyrave të Punësimit nëpër komuna. Qendrat për Aftësim Profesional (QAP) ofrojnë trajnime për të papunët dhe punëkërkuesit për një profesion të caktuar falas duke u fokusuar në aplikimin e shkathtësive dhe njohurive praktike duke përdorur mësimin në kabinete të ndryshme, ku në këtë mënyrë synojnë të rrisin perspektivën e pjesëmarrësve në punësim ose ruajtjen e punësimit të tyre.

Sipas Agjensisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në raportin e fundit (2018), tregon se numri i të regjistruarve si të papunë në Kosovë është rreth 95.890 persona por në të njëjtën kohë janë pasqyruar vende të lira të punës prej 14.847 sosh. Mirëpo, papunësia tek të rinjtë mbetet shumë e lartë në Kosovë. Në tremujorin e parë të vitit 2019, të rinjtë në Kosovë kishin gjasa dy herë më shumë të jenë të papunë krahasuar me të rriturit. Në mesin e personave të moshës 15-24 vjeçare dhe në fuqinë punëtore, 50.6 % ishin të papunë. Papunësia është më e lartë te femrat e reja (60.8 %) se te të rinjtë meshkuj (46.0%). Probleme të papunësisë më të mëdha hasin të rinjtë joaktivë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET) të cilët janë krejtësisht të shkëputur nga tregu i punës dhe nuk marrin pjesë as në sistemin arsimor. Përqindjet e larta të këtij grupi në popullsinë e të rinjve rrisin shqetësimet në lidhje me punësimin e të rinjve në të ardhmen pasi tregon shkëputje nga tregu i punës. Përveç kësaj, një numër i madh i të rinjve të pa angazhuar në vendet me papunësi të lartë të të rinjve, siç është Kosova, mund të shkaktojë uljen e fitimeve për shkak të rritjes së konkurrencës, si dhe ka mundësi t'i kontribuojë problemeve sociale. Në tremujorin e parë të vitit 2019, 99,613 apo 29.0% të rinj (të moshës 15 deri 24) në Kosovë nuk ndiqnin shkollimin, nuk ishin të punësuar apo në trajnim. Pjesa e femrave NEET është 30.3% krahasuar me 27.8% të meshkujve Në tremujorin e parë të 2019, shkalla e punësimit është 28.2 %, shkalla e papunësisë është 26.9 % ndërsa shkalla e jo aktivitetit është 61.3 %.

4. Gjetjet e studimit

4.1. Të dhëna demografike

Numri i të anketuarve ishte 561. Nga këta, 230 apo 44.49% ishin djem dhe 287, apo 55.51%, ishin vajza. Ndërsa Moshë mesatare e të anketuarve është 17.64 vjeç. Një faktor i rëndësishëm që duhet shikuar sa i përket analizës në këtë aspekt është vendbanimi i të anketuarve, me supozimin se të rinjtë e zonave rurale dhe urbane janë të ekspozuar ndaj faktorëve të ndryshëm social dhe ekonomik që ndikojnë vendimin e tyre për studime. Në këtë aspekt, shpërndarja është relativisht e barabartë, ku 52% e të anketuarve janë nga zonat urbane dhe 48% janë nga zonat rurale.




Figura 1. Gjinia e të anketuarve




Figura 2. Vendbanimi i të anketuarve

Mesatarisht, të anketuarit kanë qenë të grupit të të ardhurave prej 350-450 euro, me 249 të anketuar që i takojnë grupit të të ardhurave mujore mbi 450 Euro.

Të ardhurat mujore të të anketuarve




Figura 3. Të ardhurat mujore të të anketuarve

Nota e përgjithshme mesatare e raportuar e të anketuarve është 4.13, Shikuar nga aspekti gjinor, nota mesatare e djemve është 3.93 dhe e vajzave 4.30, përderisa diferenca është statistikiisht e rëndësishme në nivelin e konfidencës 1%, duke treguar me siguri të madhe që vajzat e intervistuar kanë pasur sukses më të mirë në mësimet sesa djemtë.

Llojet e shkollave të mesme




Figura 4. Lloji i shkollave ku vijojnë mësimet të intervistuarit

Një faktor që besojmë ndikon vendimin e maturantëve për të vazhduar ose jo studimet universitare është edhe ndjekja e orientimit në karrierë gjatë shkollës së mesme, me supozimin se maturantët që kanë ndjekur orientim në karrierë janë më të përcaktuar për drejtimin që do të ndjekin në shkollë të mesme. Rezultatet janë paraqitur në grafikun më poshtë, ku shihet se një përqindje e madhe, 61% kanë deklaruar se kanë ndjekur orientim në karrierë. Mbetet të shihet nëse shkolla të caktuara kanë më shumë prirje të ofrojnë orientim në karrierë se shkolla të tjera dhe nëse këto diferenca janë signifikante.

Orientimi në karrierë




Figura 5. Përcjellja e orientimit në karrierë gjatë shkollës së mesme

Nga të gjithë të anketuarit, 80% kanë deklaruar se planifikojnë të vazhdojnë studimet universitare menjëherë pas shkollës së mesme, 8% kanë thënë se nuk planifikojnë t'i vazhdojnë ato, ndërsa 12% kanë thënë se janë të pavendosur.

Nga ata që kanë vendosur të mos i vazhdojnë studimet, opsionet më të mira që do t'i ndjekin janë punësimi i menjëhershëm dhe migrimi jashtë vendit. Ndërsa vetëm 3% nga ta janë deklaruar se kanë në plan të ndjekin trajnime dhe certifikime profesionale. Ngjashëm janë deklaruar edhe maturantët që kanë deklaruar se janë të pavendosur për vazhdimin e studimeve, duke zgjedhur migrimin jashtë vendit, punësimin e menjëhershëm në vend dhe vazhdimin e mëvonshëm të studimeve si opsionet e tyre të preferuara.

Nga ata që janë përcaktuar për të vazhduar studimet, 69% janë të përcaktuar për t'i vazhduar ato në Kosovë, 14% jashtë Kosovës dhe 17% janë të pavendosur.




Figura 6. Vendimi për të vazhduar studimet




Figura 7. Vendi i preferuar për studime

Sa i përket drejtimit të studimeve, vetëm 62% e të anketuarve kanë deklaruar se janë përcaktuar për drejtimin në të cilin do t'i vazhdojnë studimet dhe 38% kanë deklaruar se nuk janë të përcaktuar, siç tregon grafiku në vijim. Ndërkaq, një përqindje edhe më e madhe e të anketuarve, respektivisht 41%, nuk janë të vendosur për institucionin në të cilin do t'i vazhdojnë studimet. Të dy këto fakte flasin për një fenomen shqetësues, ku vendimet për drejtimin dhe institucionin e studimeve nuk merren deri në minutat e fundit, pa planifikim paraprak. Ata janë në një masë të madhe gjithashtu të pavendosur për llojin e institucionit ku do t'i vazhdojnë studimet (publik apo privat). Të dhënat e mbledhura përmes anketës tregojnë se 45% e tyre kanë përzgjedhur universitetet publike, 28% institucionet private dhe 27% të tjerë janë të pavendosur.

Vendimi për drejtimin e studimeve




Figura 8. A e kanë zgjedhur maturantët drejtimin e studimeve

Vendimi për institucionin e studimeve




Figura 9. A e kanë zgjedhur maturantët institucionin ku do t'i vazhdojnë studimet

Lloji i institucionit




Figura 10. Lloji i institucioneve të preferuara

Institucionet e përzgjedhura




Figura 11. Institucionet e preferuara për studime

Për mungesën e planifikimit në procesin e vendimit për studime tregon edhe fakti që 55% e të anketuarve që kanë deklaruar se do t'i vazhdojnë studime, kanë deklaruar se nuk kanë një listë me opsione rezervë nëse nuk pranohen në zgjedhjen e tyre të parë.

Lista me opsione




Figura 12. Ekzistimi i listave me opsione rezervë për institucionet e studimit

4.2. Faktorët që ndikojnë përzgjedhjen e drejtimit të studimeve

Për sa i përket faktorëve që ndikojnë pranimin në programet e dëshiruara të studimeve, të anketuarit kanë favorizuar rezultatin në provimin pranues në fakultet, të cilin e kanë vlerësuar si më të rëndësishmin 48% e të anketuarve, pastaj pikët e testit të maturës i kanë konsideruar si më të rëndësishmet 42% e të anketuarve, përderisa nota mesatare është e treta për nga rëndësia, e përzgjedhur nga 37% e të anketuarve. Në përgjithësi, vlerësimin më të madh e kanë rezultatet e provimit pranues, me peshë 4.07 nga 5.




Figura 13. Faktorët që ndikojnë pranimin në studime sipas besimit të maturantëve

Kujdes më i theksuar në analizë u është kushtuar faktorëve që ndikojnë zgjedhjen e drejtimit të studimeve nga maturantët. Këtu, të anketuarve u është kërkuar të vlerësojnë me shkallë nga 1 (aspak ndikim) deri në 5 (ndikim të plotë) disa faktorë që është menduar se mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre. Rezultatet tregojnë se faktori më i rëndësishëm që ndikon vendimin për studime sipas maturantëve të anketuar është pasioni i tyre për të njohur fushën përkatëse, me vlersim 4.07 nga 5, pastaj aftësitë dhe prirjet e maturantëve (3.94), pasuar nga pritjet për të ardhura në të ardhmen (3.82), vazhdimi i trashëgimisë familjare (3.79) dhe mundësia që ofron ajo fushë për të dhënë kontribut në shoqëri (3.69). Grafikisht të paraqitura më poshtë.

Faktorët që ndikojnë vendimin për studime




Figura 14. Faktorët që ndikojnë vendimin e maturantëve për studime

Njejtë, maturantët janë pyetur për faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e institucionit ku do t'i vazhdojnë studimet. Përgjigjet e marra nga ta tregojnë se faktori që ka më së shumti ndikim në këtë aspekt është cilësia e mësimdhënësve në insitucione (3.91), pasuar nga lehtësitë e ofruara nga institucioni për gjetjen e punës praktike (3.73) reputacioni i institucionit të arsimit të lartë (3.63), shkalla e punësueshmërisë së të diplomuarve të institucionit (3.61) dhe mundësitë për shkëmbime dhe bursa dërkombëtare (3.54). Të paraqitura grafikisht në vijim:

Faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e institucionit




Figura 15. Faktorët që ndikojnë zgjedhjen e institucionit për studime

Burimet e informacionit të përdorura gjatë përzgjedhjes së institucionit janë tregimet e të tjerëve për përvojat personale, rrjetet sociale dhe kontaktet e drejtpërdrejta me personelin e institucioneve. Ndërsa më pak të përdorurat janë mediat tradicionale, portalet elektronike dhe personeli i shkollave. Ndërsa burimet më të besuara mbasin tregimet e të tjerëve, personeli i shkollës dhe mediat sociale, paraqitur në grafikun në vijim.

Burimet e informacionit më të përdorura




Figura 16. Burimet e informacionit më të përdorura nga maturantët

Burimet më të besuara të informacionit




Figura 17. Burimet më të besuara nga maturantët

Një aspekt tjetër për të cilin janë pyetur të anketuarit është ajo se kush do t'i financojë studimet e tyre. Rezultatet tregojnë se për përqindjen më të madhe të maturantëve, 61.88%, burim i financimit të studimeve do të jetë familja, ndërsa 26.75% prej tyre do t'i financojnë vetë studimet e veta. Burimet e tjera si bursat e ndryshme, familja dhe të afërmit në diasporë etj. përbëjnë përqindje të ulët të financimit. Shiko grafikun në vijim.





Figura 18. Burimet e financimit të studimeve

4.3. Pritjet e maturantëve për profesionet dhe të ardhurat e ardhshme

Planet kryesore të të anketuarve pas diplomimit përfshijnë vazhdimin e menjëhershëm të studimeve postdiplomike ose punësimin. Opsioni më i preferuar për punësim duket të jetë në vend, të cilin e kanë zgjedhur 44% e të anketuarve, me një differencë të vogël nga punësimi i dëshiruar jashtë vendit, të cilin e kanë zgjedhur 39% e të anketuarve. Përderisa të pasigurtë janë 17% e të anketuarve/. Ndërsa për ata që kanë vendosur punësimin në vend si opsionin e tyre të preferuar, opsioni më i preferuar për punësim mbetet sektori publik (3.83) pasuar nga organizatat ndërkombëtare (3.54) dhe opsione të tjera (2.44).

Planet pas diplomimit



Punësimi i dëshiruar




Figura 19. Planet e maturantëve pas diplomimit

Figura 20. Vendi i dëshiruar i punësimit të maturantëve

Maturantët besojnë se faktorët kryesorë që ndikojnë në suksesin e tyre në gjetjen e një pune në të ardhmen janë aftësitë nga shkollimi, zgjedhur nga 48% e maturantëve, pasuar nga përvoja praktike gjatë shkollimit, e zgjedhur nga 29% e maturantëve dhe nga njohjet familjare ose ndërhyrjet, e zgjedhur nga 8% e maturantëve.




Figura 21. Faktorët që ndikojnë në gjetjen e punës

5. Perfundime dhe rekomandime

Rreth 39% e maturantëve kanë deklaruar se nuk kanë marrë ose nuk e dinë nëse kanë marrë këshillim për karrierë në shkollat e tyre gjatë shkollës së mesme.

Vetëm gjysma e maturantëve janë të përcaktuar për drejtimin e studimeve që në muajin maj të vitit të fundit të shkollës së mesme, ndërsa më pak se gjysma janë të përcaktuar për institucionin ku do të vazhdojnë studimet. Krahasuar me vendet e zhvilluara të botës, ku vendimi për drejtimin e studimeve dhe institucioni ku do të regjistrohen merret që në fillim të shkollës së mesme, ky nivel pasigurie është i lartë dhe le mundësinë për të spekuluar që edhe vendimet për regjistrim në studime merren në momentin e fundit, gjë që çon drejt zgjedhjeve impulsive, të gabuara dhe që nuk përshkruan me preferencat e të rinjve apo me perspektivat e tyre për karrierë. Sidoqoftë kjo fushë kërkon studim të mëtejshëm.

Maturantët, siç edhe pritej, preferojnë institucionet publike kundrejt atyre private për t'i vazhduar studimet. Zgjedhja e parë e studentëve mbetet Universiteti i Prishtinës, pasuar nga Kolegji AAB, Kolegji UBT dhe Kolegji Universum. Përtej preferencave primare, më shumë se gjysma e maturantëve nuk kanë një listë me opsione të tjera të përcaktuara nëse nuk pranohen në zgjedhjen e tyre të parë.

Maturantët nuk identifikojnë një faktor të vetëm si më të rëndësishmin në suksesin e tyre për regjistrim në arsimin e lartë. Ata konsiderojnë që nota mesatare gjatë shkollës së mesme, pikët në testin e maturës, pikët në provimin pranues, numri i vendeve të lira dhe njohjet personale kanë ndikim pothuajse të barabartë në suksesin e një nxënësi për regjistrim në një institucion të arsimit të lartë.

Faktorët që më së shumti ndikojnë përzgjedhjen e drejtimit janë faktorët e brendshëm si aftësitë dhe prirjet dhe pasioni për fushën/. Përderisa faktorët e jashtëm si pritjet për të ardhurat në të ardhmen, vështirësia e pranimit në një program, apo mundësitë për studime post-diplomike duket të jenë faktorë më pak të rëndësishëm.

Maturantët kanë tendenca të zgjedhin institucionet arsimore që kanë mësimdhënës më cilësorë, që ofrojnë më shumë lehtësi në gjetjen e punës praktike dhe që kanë reputacion më të mirë. Ndërsa, shkalla e punësueshmërisë së të diplomuarve, që merret si tregues kryesor i cilësisë në vende të tjera, këtu del të jetë si faktori i katërt më i rëndësishëm. Ata gjithashtu përdorin të gjitha burimet e informacionit për t'u informuar rreth institucioneve arsimore dhe programeve të studimeve, por më të besueshmet për ta janë mediat tradicionale dhe portalet elektronike dhe më së paku të besueshme janë tregimet e të tjerëve.

Ndërsa, studimet e të rinjve financohen në masën më të madhe nga familja në Kosovë, pasuar nga të ardhurat e vetë studentëve dhe nga të ardhurat e familjarëve në diasporaë.

6. Bibliografia

- Cojocar, A. (2017). *Diagnoza e vendeve të punës- Kosovë*. From World Bank Group:
<http://documents.worldbank.org/curated/en/519991508764269649/pdf/ACS21442-WP-ALBANIAN-93p-KOSOVO-Jobs-Diagnostic-Final-for-printing-ALB.pdf>
- Cullen et al. (2016, June 29). *Young Student's Motivations to Choose an Undergraduate Midwifery Program*. From National Library of Medicine: <https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/26616561/>
- Ingels, S.J., and Dalton, B. (2013, March). *High School Longitudinal Study of 2009 (HSL:09) First Follow-up: A First Look at Fall 2009 Ninth Graders in 2012 (NCES 2014-360)*. From U.S. Department of Education: <http://nces.ed.gov/pubsearch>
- Sathapornvajana and Watanapa. (2012, December 10). *Factors Affecting Student's Intention to Choose IT Program*. From Procedia Computer Science:
https://www.researchgate.net/publication/257719411_Factors_Affecting_Student's_Intention_to_Choose_IT_Program
- Smith, T. H. (2012). *Widening participation in higher education*. United Kingdom: Palgrave Macmillan. From University of Sussex.
- Uyar et al. (2011, September 10). *Factors Affecting Students Career Choice In Accounting: The Case Of A Turkish University*. From ResearchGate:
https://www.researchgate.net/publication/298728962_Factors_Affecting_Students_Career_Choice_In_Accounting_The_Case_Of_A_Turkish_University
- Yousef et al. (2017, November 22). *Association Between Depression and Factors Affecting Career Choice Among Jordanian Nursing Students*. From National Library of Medicine:
<https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/29214151/>